



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 249/2020
Datë: 05 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 11 dhe 12 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen 241-të, të mbajtur përmes komunikimeve elektronike, më datë 05 nëntor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Ilmi Bajrami, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, caktohet kryesues për të shërbyer në Panelin Hetimor në lëndën AD/KGJK/30/2020/AD/GJTHPE/09/20.
- II. Zgjatjen hetimet edhe për dy (2) muaj në rastin disiplinor AD/KGJK/30/2020/AD/GJTHPE/09/20.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 05 nëntor 2020.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 06 gusht 2020, me vendimin KGJK.nr.214/2020, ka themeluar Panelin Hetimor për rastin disiplinor AD/KGJK/30/2020/AD/GJTHPE/09/20 dhe ka caktuar kryesues të këtij paneli z. Lekë Prenaj.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.248/2020, të datës 31.10.2020, ka pezulluar nga detyra z. Prenaj, andaj si rezultat i rrethanave të tilla të krijuara, e bazuar në nenin 12 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në takimin përmes komunikimit elektronik, ka përcaktuar për kryesues të panelit z. Ilmi Bajramin, i cili me vendimin KGJK.nr.214/2020, ka qenë i caktuar si anëtar i parë rezervë i këtij paneli. Po ashtu, gjatë periudhës së zhvillimit të hetimeve kryesuesi i Panelit Hetimor z. Lekë Prenaj, në rastin disiplinor të lartë cekur, është infektuar me covid – 19 dhe është dashur të vetë izolohet për disa javë, për çka edhe hetimet nuk kanë mundur të përfundojnë brenda afatit prej 3 muajve.

Andaj, në këtë takim është shqyrtuar dhe miratuar kërkesa për zgjatje të afatit edhe për një periudhë kohore për dy (2) muaj, duke vlerësuar se deri më datë 06 nëntor 2020 kur bëhen tre (3) muaj, nuk mund të përfundohet hetimi. KGJK, ka konstatuar se kjo kërkesë është e bazuar nga shkakun se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 12 paragrafi 8 i Ligjit Nr. 06/L-07 për Përgjegjësinë

Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që të zgjatet afati për hetim edhe për një periudhë kohore për dy (2) muaj.

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Lekë Prenaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë;
- Z. Ilmi Bajrami, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
- Anëtarëve të Panelit Hetimor, si dhe
- Arkivit.